

Kthim pergjigje Nr. 200 Fri 1/15/2021 10:47 AM

To:kkeruti@partnersalbania.org;

...

Përshëndetje Zj. Keruti!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 159 në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

- Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara deri në 31 Dhjetor 2020 është 4972 ((bashkëngjitur lista e plotë).
- Numri total i organizatave jofitimprurëse të regjistruara gjatë vitit 2020 është 186.
- Organizatat jofitimprurëse të ndara sipas statusit aktual janë: aktiv 2185, pasiv 2568.
- Numri i organizatave jofitimprurëse, me përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, në total është 1262, ndërsa për vitin 2020 është 158.
- Numri i organizatave jofitimprurëse të cregjistruar nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së është 182
- Organizata jofitimprurëse që nuk kanë m.w. përgjegjësi tatimore me TVSH janë 1590.
- Numri i të punësuarve në organizatat jofitimprurëse referuar periudhës së fundit të plotë të deklaruar Shtator 2020 është 9793 (nga informacioni që disponojmë, nuk kemi të dhëna në lidhje me punonjësit e punësuar me kohë të pjesshme, si dhe vullnetarë).
- Gjate vitit 2020, nuk ka marrë asnjë OJF certifikatë të regjistrimit të projektit për efekt të rimbursimit të TVSH-së, gjithashtu, gjatë vitit kalendarik 2020 nuk është rimbursuar për TVSH asnjë OJF.
- Numri total i organizatave jofitimprurëse që kanë qënë objekt kontrolli të plotë gjatë vitit 2020 është 20. Prej tyre janë përfunduar 5 kontrolle. Të gjitha kontrollet për vitin 2020 janë planifikuar bazuar në Udhëzimin Nr.19, datë 09.07.2019 - "Për mbikëqyrjen e organizatave jofitimprurëse në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"
- Sanksionet për OJF-të dhe arsyet e vendosjes se tyre janë si më poshtë vijon:

Nr. Sanksioneve	Arsyeja
1	Dënim për mospajisje me pajisjet fiskale për herë të parë
40	Gjoha inspektori Per mosdeklarim punonjesish

4	Gjoba inspektori TVSH Leshim Fature Tatimore te Pasakte
9	Gjoba per mosmbajtjen e sakte te librave, regjistrave dhe dokumentacionit
2	Gjobe inspektori per evazion fiskal dhe fshehja detyrimi
4	Gjobë inspektori për mosdeklarim në organet tatimore të llogarive bankare për herë të dytë
28	Mosdhenia e informacionit
1	Tatimi mbi qerane Gjoba inspektori Evazion fiskal dhe Fshehje Detyrimi
2	Te tjera tatime ne burim Gjoba inspektori Evazion fiskal dhe Fshehje Detyrimi
91	

- Detyrimet tatimore të papaguara nga organizatat jofitimprurëse për vitin 2020, janë si më poshtë vijon:

Tatim mbi të ardhurat personale - 13,844,354 lekë nga 152 OJF

Sigurime Shoqërore - 111,053,170 lekë nga 1178 OJF

Sigurime Shëndetsore - 10,655,305 lekë nga 714 OJF

- OJF-të nuk janë përfitues të paketës COVID, pasi nuk janë konsideruar si TP që nuk i lejohet aktiviteti.

Faleminderit për mirëkuptimin.